

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Suharekës

31 Dhjetor 2011

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
1 Hyrje	5
2 Opinioni i Auditimit.....	7
3 Gjendja e rekomandimeve të viteve paraprake	11
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar	12
5 Pasqyrat Financiare – Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave	13
6 Menaxhimi Financiar	14
▪ 6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)	14
▪ 6.2 Shpenzimet	15
▪ 6.3 Asetet.....	18
▪ 6.4 Menaxhimi i borxheve	19
▪ 6.5 Raportimi kohor aktual në procesin e përgjithshëm të buxhetit.....	20
7 Kontrollët e menaxhmentit.....	21
▪ 7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm	21
▪ 7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm	21
8 Konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Suharekës	22
Shtojca I. Llojet e ndryshme të opinioneve bazuar ne ISAAI 400.....	23
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	25
Shtojca III: Komentet e Komunës dhe përgjigjet e Auditorit	28

Përmbledhje e Përgjithshme

Grant Thornton Sh.p.k në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi jonë është kryer në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit ("ONISA") dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion mbi pasqyrat financiare.

Ju lutem gjeni më poshtë një ekstrakt të marrë nga opinionimi jonë i auditimit nga faqja 7 e këtij dokumenti:

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin 1 dhe 2 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme ("SNKSP") Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Porositë kryesore ndaj Kryetarit, të cilat na shpien në kualifikim të opinionit janë:

1. Komuna nuk mban listimet e duhura të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së të dhënave të mbajtura në kontabilitet dhe sistemet operative për pagesat nga palët e treta, si dhe mungesës së kontroleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejm teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të verifikuar plotësinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2011
2. Shpalosja e disa informacioneve shpejguesë të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar në baza të parasë së gatshme të kontabilitetit dhe Rregullës Financiare Nr.07/2011 Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk është përgatitur nga Komuna për fundvitin 31 Dhjetor 2011. Në veçanti, të dhënat në vijim janë lënë jashtë apo janë paraqitur në mënyrë të parregullt në pasqyrat financiare

- Lidhur me Nenin 13 Raporti për ekzekutim buxhetor dhe Nenin 18 buxheti fillestar dhe final, shuma e paraqitur në kolonën e buxhetit final në raporte nuk përputhet me shumën buxhetore në SIMFK për 103 mijë EURO. Tutje, shuma në nenin 13 raporti për ekzekutim buxhetor, kolona A nuk përputhet me nenin 18 Buxhetit fillestar dhe final të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
- Neni 14 Shenimi 1 informacioni për organizatën buxhetore nuk është shpalosur.
- Përvetësimi i fondeve të përgjithshme siç është raportuar në Nenin 12 “Pasqyra e Parasë së Pranimeve dhe Pagesave” dhe Shënimi 2 nuk përputhen me vlerën e tanishme në SIMFK për vlerën 38 mijë EURO.
- Pagesat nga palët e treta nuk janë shpalosur në Shenimin 6.
- Neni 16, Shënimi 34 mbi Llogaritë e Arkëtueshme (të përdorura nga organizatat që arkëtojnë të hyrat), llogaritë e arkëtueshme të raportuara nuk janë mbështetur me dokumente të besueshme si tatimi në pronë, taksat biznesore dhe taksat e lejeve të punës.

Kontrollat e brendshme

Auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në disa sfera të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë përshkruar në mënyrë më të detajuar përbrenda raportit.

Përfundimi ynë është që sistemet e brendshme të Komunës janë dizajnuar, por nuk janë zbatuar plotësisht.

Në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollat e brendshme, ne ju rekomandojmë të siguroni që:

- Pasqyrat financiare të jenë të pregaditura në përputhshmëri me udhëzimet aktuale administrative dhe SNKSP-në;
- Të mbahet një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Të mirren masa për të rritur mbledhjen e të ardhurave nga taksat e ndryshme;
- Të jetë plotësisht në përputhje me Ligji nr. 03/L-241 rregulluar 04/L-042 “Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë”, dhe
- Komiteti i Auditimit të jetë funksional.

Menaxhmenti i Komunës i është dhënë mundësia të komentojë në gjetjet e paraqitura në këtë raport. Menaxhmenti është pajtuar të bëjë gjithë çka që është e mundur për të adresuar rekomandimet tona në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm, pasqyrat financiare, prokurimin, borxhet, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, funksionalizimin e Komitetit të Auditimit dhe raportimin në kohë.

1. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës të përgatisë pasqyrat financiare në përputhshmëri me Rregullat Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar nën Baza të Kontabilitetit për Paranë e gatshme”.

Grant Thornton Shpk, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullt vjetor të pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi është një vërtetim i kontabilitetit financiar, i cili përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare dhe ofron siguri:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe saktë për llogaritë dhe çështjet financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Mbi përshtatshmërinë e kontrolleve të brendshme dhe funksioneve të auditimit të brendshëm; dhe
- Për qfardo çështje të rëndësishme që rrjedh nga ose ndërlidhet me auditimin.

ZAP-i ka kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës. Gjatë asaj periudhe të procesit të auditimit ka adresuar trajtimin e rekomandimeve të cilat ju kanë dhënë më herët Komunës si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Bazuar në këtë ai ka dhënë rekomandime menaxhmentit. Rekomandimet e tij kanë përfshirë gjithashtu këshilla lidhur me përmirësimet për pasqyrat financiare që të jenë në përputhshmëri me Rregullën Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) për “Raportimin Financiar nën Baza të Kontabilitetit për Paranë e gatshme”. Kjo gjithashtu përfshinte këshilla lidhur me përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare. Rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë dorëzuar nëpërmjet memorandumit të auditimit të datës Dhjetor 2011.

Në mënyrë që të përmbushim përgjegjësitë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Kemi krahasuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës me buxhetin e aprovuar për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgaditur në përputhshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar nën Kontabilitetin e bazave të parasë së gatshme” dhe Rregullën Financiare 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësim në përcaktimin e llojit të mendimit që duhet dhënë për pasqyrat financiare;

- Kemi përdorur një kombinim të gjykimit dhe mostrimit të thjeshtë për të përzgjedhur transaksionin për testim;
- Kemi kryer teste substanciale të transaksioneve financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumentave dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe drejtësinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit dhe sigurojmë mendimin tonë për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

ONISA ka vendosur kritere të veçanta që përcaktojnë llojin e mendimit që do duhej dhënë në lidhje me mendimin tonë të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës.

Këto janë të paraqitura më detajisht në Shtojcën 1.

2. Opinioni i Auditimit

Grant Thornton LLC
 Rr. Rexhep Mala 18
 10 000 Prishtina
 Republic of Kosovo

Raporti i Auditorit të Pavarur

T +381 38 247 771
 T +381 38 247 801
 F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Kuvendin Komunal
 Komuna e Suharekës, Kosovë

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Suharekës (“Komuna”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) “Raportimi Financiar Bazuar në Paranë e Gatshme” dhe me Rregulen Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe për kontroll të brendshëm që menaxhmenti e përcakton të nevojshëm për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në ato rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve

kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar.

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Komuna nuk ka mbajtur lista të duhura të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operationale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë së kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2011.
2. Disa shpalosje të kërkuara nga SNKSP Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore nuk janë bërë nga ana e Komunës në përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011. Në veçanti, çështjet në vijim janë lënë jashtë ose shpalosur në mënyrë të gabuar në pasqyrat financiare:
 - Lidhur me Nenin 13 të raportit për ekzekutim buxhetor dhe Nenin 18 të buxhetit fillestar dhe final, shuma e paraqitur në kolonën e buxhetit final në raporte nuk përputhet me shumat buxhetore në FMISK për shumën prej 103 mijë EURO. Tutje, shuma në nenin 13 raporti për ekzekutim buxhetor, kolona A nuk përputhet me nenin 18 buxheti fillestar dhe final të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
 - Neni 14, Shënimi 1 informacioni mbi organizaten buxhetore nuk është shpalosur.
 - Ndarjet e përgjithshme buxhetore sipas raportit në nenin 12 “Pasqyra e pranimeve të parase dhe pagesave” dhe Shenimi 2 nuk përputhet me vlerën aktuale në FMISK për vlerën 38 mijë EURO.
 - Pagesat nga palët e treta nuk janë shpalosur në Shënimin 6.
 - Neni 16, Shënimi 34 mbi llogaritë e arkëtueshme (përdoret për mbledhjen e të ardhurave nga organizatat), llogaritë e arkëtueshme të raportuara nuk janë mbështetur me dokumentacion të besueshëm si tatami në pronë, taksat biznesore dhe lejet e punës.

Prandaj ne nuk kemi qenë në gjendje të marrim siguri të mjaftueshme mbi plotësinë dhe përputhshmërinë e informacioneve financiare të prezentuar në pasqyrat financiare të Komunës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2011.

Opinion i Kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafin 1 dhe 2 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme

(“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Rishikim i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e menaxhmentit për përputhshmërinë

Menaxhmenti është përgjegjës për dizajnimin dhe zbatimin e kontrollit të brendshëm që të sigurojë se aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara janë në përputhshmëri me autoritetet që i qeverisin ato.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me UAPLAPF 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se dëshmia e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzioni mbi përputhshmërinë

Bazuar në rishikimin tonë, për shkak të ndikimit në pasqyrat financiare të çështjeve të shpjeguara në paragrafët 1 dhe 2 të “bazat për mendim të kualifikuar” dhe çështjeve të tjera të theksuara në pikat 3 dhe 8 të këtij raporti, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara dhe pasqyrat financiare që duhet të kenë vëmendjen tonë gjatë rishikimit, nuk janë në përputhshmëri me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne i kushtojmë vëmendje çështjeve në vijim:

1. Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Pasiqë, Free Balance-i nuk është duke u përdorur për të regjistruar pagesa nga palët e treta, prona dhe paisjet ose llogaritë e arkëtueshme, ai nuk mund të përdoret për të prodhuar pasqyra financiare gjithpërfshirëse.

2. Edhe pse Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar kanë nënshkruar një Deklaratë në lidhje me prezentimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën Serbe deri në fund të auditimit tonë
3. Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe automatik të faturimit dhe nuk mirëmban nën-llogari ose lista të ndara për të gjithë borxhlinjtë në lidhje me tatime të ndryshme. Në vend të kësaj vetëm grumbullimet e parave të gatshme nga të ardhurat janë regjistruar. Mungesa e saktësisë dhe plotësisë do të ndikojë në të ardhurat që Komuna mund t'i fitoj dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, raportimin e saktë të shkallës së grumbullimit, dhe monitorimin e grumbullimit të të ardhurave vetanake brenda kohës së duhur.
4. Komuna ka mbajtur një regjistër të plotë për pronën paisjet dhe impiantet. Sidoqoftë ne kemi vërejtur se pasuritë e regjistruara gabimisht dhe të asgjësuarat nuk janë hequr nga regjistri i aseteve, kështu që asetet janë mbivlerësuar për vlerën prej 841 mijë EURO. Gjithashtu, zhvlerësimi për vitin është mbivlerësuar për pasurinë e regjistruar gabimisht. Ne nuk jemi pajisur me deshmitë e duhura të numërimit fizik të aseteve më 31 Dhjetor 2011 dhe si rrjedhim nuk ka qenë i mundur verifikimi i regjistrave kontabël me numërimin fizik të aseteve. Dokumentet fizike të numërimit ishin përgatitur për njësi individuale me informata të kufizuara dhe nuk kishte asnjë raport gjithëpërfshirës të inventarit të numërimit në nivel komunal ashtu siç kërkohet nga Udhezimi Administrative 21/2009
5. Kemi identifikuar një numër të rasteve të mos-pajtueshmërisë me “Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë”. Këto mospërputhje janë të kërkura me procedurat e prokurimit që nuk janë kryer dhe dokumentur nga Komuna.

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
 29 Qershor 2012

3. Gjendja e rekomandimeve të viteve paraprake

Letra jonë për menaxhmentin, më dhe për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010, identifikoi pesë rekomandime kryesore. Komuna ka ndërmarrë veprime që të zgjidhen rekomandimet për shpenzimet dhe pjesërisht ka trajtuar rekomandimet për pronën, paisjet dhe impiantet, përderisa tri rekomandimet e tjera ende kanë mbetur për tu trajtuar:

- Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhshmëri me urdhëresën administrative dhe IPSAS.
- Komuna duhet të mbajë regjistër të veçantë të debitorëve të saj në sistemin e faturimit të automatizuar. Ky informacion mund të përmirësojë ndjeshëm menaxhimin e të hyrave në procesin e buxhetimit dhe inkasimit të mjeteve. Menaxhmenti gjithashtu do të përfitojë duke zbatuar procesin e faturimit dhe mbledhjes së informacionit mbi një bazë në kohë reale. Listë të detajuar të taksapaguesve individual, bizneseve aktive dhe debitorëve të gjeneruar nga sistemi është vecanërisht e rëndësishme në situatën e tanishme kur komunat nuk regjistrojnë çdo transaksion individual në Free Balance.
- Përputhja me Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë duhet të sigurohet dhe,

Dështimi për të adresuar plotësisht rekomandimet tona të dhëna, na ka shpjer që të kemi gjetje te ngjashme me vitin 2010.

4. Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve aktuale

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti përfundimtar	Arkëtimet/ Shpenzimet 2011	Arkëtimet/ Shpenzimet 2010
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	11,479,020	12,399,368	11,655,181	9,205,355
Grantet qeveritare – Buxheti	9,947,303	9,976,303	9,849,710	7,997,467
Të bartura nga viti I kaluar	-	743,602	1,154,675.16	282,928
Të hyrat vetanake 2011	1,531,717	1,634,933	608,781	904,027
Donacionet vendore	-	11,000	10,534	16,950
Donacionet e jashtme	-	33,530	31,481	3,983
II. Gjithsej Shpenzimet	11,479,020	12,399,368	11,655,181	9,205,355
Pagat dhe mëditjet	5,893,720	5,935,181	5,811,928	4,595,909
Të mirat dhe shërbimet	807,789	931,489	858,319	816,773
Shërbimet komunale	201,392	201,392	201,178	200,564
Subvencionet dhe transferet	118,607	129,291	128,565	105,449
Investimet kapitale	4,457,512	5,202,015	4,655,191	3,486,660
Rezervat	-	-	-	-
Diferenca I-II	-	-	-	-

Tabela 1 tregon se buxheti përfundimtar në total ishte EUR 12,399,368 ose përafërsisht 8% më i lartë se buxheti fillestar i miratuar me Ligjin Nr. 04/L-001. Kjo ishte për shkak të transferimit të të hyrave vetanake nga vitet e mëparshme dhe donacioneve nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm.

Në vitin 2011, Komuna ka shpenzuar 11,655,181 EURO apo 94% të buxhetit final. Buxheti i pashpenzuar në fund të vitit 2011 ishte në shumën Euro 744,187 apo 6% e buxhetit final.

Konkluzion

Fakti që 50% e shpenzimeve të përgjithshme kanë ndodhur në tremujorin e fundit tregon që Komuna ka mangësi në ekzekutimin e buxhetit. Zbatimi i programit për investime kapitale tregon se ka dobësi në proceset e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime kapitale të Komunës.

1. Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit që :

- Planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i ekzekutimit të buxhetit të komunes të përmirësohet.
- Të forcohen kontrollet e brendshme të shfrytëzimit të buxhetit në përputhje me planifikimin e tij; dhe
- Të forcohen kontrollet mbi planifikimin dhe menaxhimin e investimeve kapitale në mënyrë që të arrihet efikasitet më i lartë i ekzekutimit të kontratës në kohën e duhur.

5. Pasqyrat Financiare – Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave

Kërkesat në LPFMA Nr. 03/L-048 dhe Rregullës Financiare 07/2011.

- Pasqyrat Financiare të Komunes së Suharekës janë nënshkruar nga Zyrtares Kryesore dhe Zyrtares Kryesore e Financave;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda afatit kohor të duhur 31/01/2012 dhe janë dorëzuar në MF;
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe;
- Komuna ka përgaditur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore në MF gjatë vitit 2011

2. Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin të sigurojë që përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë paraqitur për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Për më tepër Komuna duhet të përgatisë pasqyrat financiare në gjuhën serbe siç kërkohet nga ligjet aktuale.

6. Menaxhimi Financiar

6.1 Të ardhurat (përfshirë edhe të hyrat vetanake)

Të gjeturat

Sistemet e faturimit. Me përjashtim të tatimit mbi pronë, taksave biznesore dhe qirasë, menaxhmenti i komunës nuk mban libra të veçantë të llogarisë ose lista të të gjithë debitorëve (borxhlive) të saj për taksat e ndryshme. Për më shumë, listat e taksave biznesore dhe qirasë nuk janë të sakta për shkak të bilanceve negative të identifikuara dhe shumave që nuk ndërlidhen me konsumatorë.

Për kategoritë tjera të të ardhurave për të cilat sistemi i faturimit është i nevojshëm, ai nuk është aplikuar. Dhe në vend të kësaj vetëm mbledhjet e parave të gatshme (kesh) nga të ardhurat e tilla janë regjistruar.

Të ardhurat nga licensat e biznesit. Komuna ka marrë masa dhe ka kërkuar për të konfirmuar numrin e bizneseve që kanë vepruar në Komunë me listën e bizneseve sipas Autoritetit Tatimor dhe Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, por nuk ka marrë ende informacione relevante nga autoritetet përkatëse. Prandaj, bizneset joaktive ose të përfunduara mund të obligohen që të paguajnë, ndërsa bizneset aktive ose të reja nuk ngarkohen.

Deponimet e parave të gatshme. Parat e mbledhura nga njësite komunale në fshatra nuk deponohen brenda 48 orëve ashtu siç kërkohet nga rregulloret.

Konkluzion

Mungesa e saktësisë dhe plotësisë së librave të llogarive të arkëtueshme do të ndikojë në të ardhurat që Komuna mund t'i fitojë. Pa regjistrime të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve (borxhlive) dhe raporte mbi grumbullimin e të ardhurave, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, apo të raportojë shkallën e saktë të grumbullimeve, e as të ndjek me kohë grumbullimin e të hyrave vetanake. Për më shumë, grumbullimi i ulët i të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin investues të Komunës.

Kontrollet jo të duhura dhe të pamjaftueshme që kanë të bëjnë me të ardhurat dhe softuerët adekuat dhe sistemin e faturimit rrisin rrezikun e manipulimit të shifrave dhe keqpërdorimit të informatave. Një sistem i tillë mund të shpie në faturim jo të plotë dhe të ardhura jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e interfejsit të sistemit të faturimit dhe kontabilitetit ekspozon Komunën ndaj rrezikut shtesë për gabime. Përveç kësaj, kjo shkakton kosto shtesë për mbajtje të regjistrimeve, rishikimin dhe bashkërendimin e informatave.

Lista e hollësishme dhe e përditësuar (e ndryshuar vazhdimisht) e taksapaguesve individual, bizneseve aktive dhe borxhlive (debitorëve) të gjeneruar nga sistemi është veçanërisht e rëndësishme në situatën e tanishme ku komunat nuk regjistrojnë çdo transaksion individual në "Free Balance". Si pasojë, me përjashtim të tatimit mbi pronë, Thesari dhe Komuna nuk janë të pajisur me një listë të hollësishme

të prodhuar nga sistemi i kontabilitetit ose nga sistemi i faturimit. Si rezultat, nuk është e mundur të bëhet një bashkërendim(barazim) i duhur ose analizë nga debitori.

3. Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin që të sigurojë që Komuna të ndërmerr hapa për të përmirësuar sistemet e faturimit dhe kontabilitetit me qëllim që të sigurohen kontrole të sigurt, efikase dhe efektive në faturim dhe të ardhura. Përmirësimi i procedurave të lidhura me sisteme të tilla do t'i mundësojë menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha, dhe të sigurojë se vendimet që lidhen me buxhetimin, planifikimin dhe grumbullimin e të ardhurave janë kryer ashtu siç duhet. Ne rekomandojmë që Komuna të:

- Implementojë një sistem të faturimit që përfshinë detaje të azhuruara rreth pagesve, adresave të tyre aktuale, historisë dhe vlerësimit të grumbullimit. Në informata të tilla duhet të kenë qasje vetëm për një numër i kufizuar personash, me autorizim të menaxhmentit.
- Ndërlidh automatikisht sistemin e faturimit me softueret e kontabilitetit ku informacioni procesohet automatikisht në librin e përgjithshëm të llogarive.
- Kryej barazime (bashkërendime) në mes të dy sistemeve në baza të rregullta për të gjitha llojet e të ardhurave. Çdo dallim gjatë barazimit duhet të ndiqet menjëherë dhe rregullohet në kohën e duhur.
- Lidh njesitë operative dhe të faturimit automatikisht dhe të kryej barazime(bashkërendime) të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimi është i lidhur drejtpërdrejtë me shërbimet e ofruara nga njesitë operative. Kjo është veçanërisht e rëndësishme atëherë kur ekzekutohet një vëllim i madh i transaksioneve.
- Marrë informata nga Qendra e Regjistrimit të Biznesit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në lidhje me bizneset që veprojnë në Komunë dhe ti ngarkojë ato me taksa të përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret.
- Ne këshillojmë komunën që të sigurohet se paratë e gatshme të mbledhura të deponohen në bankë brenda afatit të kërkuar.

6.2 Shpenzimet

Të gjeturat

Në blerjen e drurëve për ngrohje në vlerë prej 8,096 Euro të regjistruar me CPO nr 258022, faturë nr. 394525, me datë 02 Nëntor 2011 dhe pagesë të bërë me 21 Nëntor 2011, komisioni nuk ka dhënë ndonjë specifikim në lidhje me sasinë e drurit që është pranuar.

Për më shumë kur është bërë blerja e materialeve shkollore në vlerë prej 272 EURO e regjistruar me CPO nr 128987, faturë nr 118156, me datë 14 Maj 2011 dhe pagesë të bërë me 29 Qershor 2011, raporti i pranimit nuk është nënshkruar nga personi i autorizuar.

Konkluzion

Zbatimi jo i duhur i kontrolleve të vendosura mund të shpie në keqpërdorimin e aseteve të Komunës dhe mund të ketë ndikim negativ në plotësinë dhe saktësinë e informatave financiare të Komunës.

4. Rekomandim

Ne këshillojmë që Komuna të zbatojë në mënyrë rigoroze kontrollet e vendosura p.sh i gjithë dokumentacioni që ka të bëjë me pranimin e mallrave duhet të autorizohet nga personi i cili pranon mallrat dhe komisioni pranues të kryejë detyrat e tyre me përgjegjësi.

6.2.1 Kompensimet (Pagat dhe mëditjet)

Nuk ka gjetje në këtë fushë.

6.2.2 Prokurimi

Të gjeturat

Gjatë inspektimit tonë të dokumentacionit burimor në lidhje me procedurën e tenderimit të aplikuar për ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e shkollave etj, ne kemi indentifikuar parregullsi të shumta si në vijim:

- Përkatësisht, gjatë ndërtimit të Shtëpisë për Kujdes të të Moshuarve në Gjinoc/Suharekë me kontratën nr. 624-11-048-521 dhe ne shumë 372,390 Euro, ka pasur ankesa në dy proceset e mëparshme të tenderimit dhe procesi është derguar në OSHP i cili këshilloi autoritetin kontraktues për zgjedhjen e ofertuesit fitues dhe kërkoi të mirren masa kundër menaxherit të prokurimit për shkak të mungesës së përgjegjësisë dhe ndërgjësish. Megjithatë, asnjë masë nuk u ndërmorr nga menaxhmenti i komunës ndaj menaxherit të prokurimit.

Për më tepër ka pasur një vonesë në përfundimin e punëve, dhe Komuna nuk ka pranuar informata për atë vonesë. Gjithashtu, Komuna nuk ka aplikuar dënime ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e kontratës në rast se puna nuk është përfunduar me kohë. Përveç kësaj garancioni i kërkuar për ekzekutimin e punëve nuk ishte i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punës. Projekti nuk është përfundua derisa ne ishim ne auditim.

- Në ndërtimin e Qendrës Kulturore në Suharekë (faza e parë), rivitalizimi i ndërtesës së muzeut me kontratë nr. 624-11-079-521 dhe ne shumë 474,888 Euro, tenderi i është dhënë ofertuesit me tenderin ekonomikisht më të favorshëm. Ofertuesi fitues ka fituar në bazë të pikëve të marra për planin dinamik (30 ditë dhe garancion të punës për 500 vjet), të cilat nuk janë bindëse. Puna ende nuk ka mbaruar dhe nuk është aplikuar asnjë dënim ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e kontratës në rast se puna nuk përfundohet me kohë. Përveç kësaj garancioni në lidhje me ekzekutimin e punëve nuk ishte i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe marrëveshja u nënshkrua pa posedimin e faturës së KEK-ut edhe pse kjo është kërkuar në dosje te tenderit.
- Në ndërtimin e shtratit të lumit Toplluha- faza III me kontratë nr. 624-11-083-521 ne shumë 232,635 Euro, komisioni vlerësues zgjodhi fituesin e ofertuesve nga dy ofertues, edhe pse njëri nga ofertuesit nuk kishte paraqitur deklaratën tatimore për tremujorin e fundit ashtu siç kërkohet në dosjen e tenderit. Prandaj, tenderi do të duhej të ritenderohej për shkak të faktit se ka ekzistuar vetëm një ofertues i përgjegjshëm. Për më shumë, mbikëqyrësi i punës është në të njëjtën kohë antar i komisionit vlerësues. Ka pasur vonesa në kryerjen e marrëveshjes dhe Komuna nuk ka aplikuar dënime ashtu siç është paraparë me marrëveshjen e kontratës në rast se kontrata nuk ekzekutohet në kohë.

- Në ndërtimin e rrugës Peqan-Semetisht me kontratë nr. 624-11-093-521 ne shumë 47,399 Euro, ka pasur vonesa (kontrata e nënshkruar me 10.10.2011 punët do të duhej të perfundonin për 27 ditë) në kryerjen e marrëveshjes dhe Komuna nuk ka aplikuar dënimet ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e kontratës ne rast se kontrata nuk ekzekutohet në kohë. Përveç kësaj garancioni i kërkuar në lidhje me ekzekutimin e punëve nuk ishte i vlefshëm gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punës.
- Në ndërtimin e shkollës në fshatin Mohlan me kontratë nr. 624-11-057-521, ne shumë 186,466 Euro, ka pasur vonesa në kryerjen e marrëveshjes dhe Komuna nuk ka aplikuar dënimet ashtu siç është paraparë në marrëveshjen e kontratës në rast se kontrata nuk ekzekutohet në kohë.
- Komuna ka nënshkruar marrëveshjen për shërbime profesionale për kopshtin e fëmijëve me kontratë nr. 624-11-200-236. Marrëveshja është nënshkruar me personin fizik për ofrimin e shërbimeve për kujdes të veçantë të fëmijëve në kopsht. Ofertuesi fitues është person fizik dhe në marrëveshja është nënshkruar për pagesë mujore prej 267 EURO për 24 muaj. Klienti nuk e ka përfshirë në marrëveshje ndaljen e tatimit me qëllim që të bëjë të përgjegjshëm ofertuesin fitues për pagësën e tatimit mbi të ardhurat personale dhe nuk ka kërkuar formën e kthimin mujor të tatimit si dëshmi se tatimi mbi të ardhurat personale është paguar. Për më tepër pagesa për muajin Dhjetor 2011 është dhënë në avans, gjë që nuk është në përputhje me marrëveshjen.

Konkluzion

Mungesa e komunikimit dhe miratimet nga autoritetet në kohë apo dokumentacioni jo i plotë në dosjet e prokurimit mund të çojë në mospërputhje me ligjet dhe kërkesat e kontratës dhe në humbje të mëdha. Përveç kësaj, mos aplikimi i kamatës ndëshkuese siç është rënë dakord në kontratë rezulton në humbje të të ardhurave.

5. Rekomandim

Ne rekomandojm Krytearin që të siguroj që:

Komuna të vendosë procedura kontrolluese adekuate të mjaftueshme për monitorim efektiv për të siguruar përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Ne rekomandojmë që Komuna të aplikojë ashtu siç duhet termet dhe kushtet kontraktuale dhe të aplikojë dënimet kur kontraktuesi perfundon projektin në kohë. Kjo vlen sidomos kur kërkesa për zgjatjen e afatit para se të skadojë siç përcaktohet në kontratë, nuk është dorzuar. Për më shumë, Komuna duhet të sigurojë se kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit janë të logjikshme dhe ofertuesit fitues te respektojnë kushtet e ofruara (garancionet e dhena dhe planin dinamik).

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Të gjeturat

Komuna nuk ka politikë të shkruar për subvencione, që do të përmbajë kriteret dhe procedurat për ndihmë, kështu që subvencionet lejohen vetëm në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës.

Konkluzion

Në mungesë të komunikimit dhe miratimeve në kohë nga autoritet ose dokumentacionit jo të plotë mund të vie deri te mospërputhja me ligjet ose kërkesat e kontratës dhe humbje te konsiderueshme.

6. Rekomandim

Ne rekomandojm Krytearin që të siguroj që;

Komuna të vendosë procedura kontrolluese adekuate të mjaftueshme për monitorim efikas në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

6.3. Asetet

6.3.1 Trajtimi i parave të gatshme (dhe ekuivalentët e tyre kur është e aplikueshme)

Të gjeturat

Njësitë komunale në fshatra nuk deponojnë të hollat e mbledhura brenda 48 orëve siç kërkohet nga rregulloret.

Konkluzion

Në mungesë të deponimit në kohë të parave të gatshme mund të rritet rreziku i keqpërdorimit të fondeve.

7. Rekomandim

Ne këshillojmë Kryetarin që të sigurohet se paratë e gatshme të mbledhura nga pjesëmarrja të deponohen në bank brenda afatit të kërkuar.

6.3.2 Trajtimi i llogarive të arkëtueshme

Të gjeturat

Me përjashtim të tatimit mbi pronë, taksave biznesore dhe qirasë, menaxhmenti i komunës nuk mban libër të veçantë të llogarisë ose lista për të gjithë borxhli të saj në lidhje me taksat e ndryshme. Për më tepër në librat e llogarisë për taksat biznesore dhe qiranë nuk janë të saktë për shkak të bilanceve negative të identifikuara dhe shumave që nuk ndërlidhen me konsumatorët.

Konkluzion

Mungesa e saktësisë dhe plotësisë së librave të llogarive të arkëtueshme do të ndikojnë në të ardhurat që Komuna mund t'i fitojë. Pa regjistrime të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve (borxhlive) dhe raporteve për grumbullime, Komuna nuk është në gjendje të pregadisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, të raportojë një shkallë të saktë të mbledhjes, e as të ndjek grumbullimin e të hyrave vetanake me kohë. Për më tepër, grumbullimi i ulët i të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin e investimeve të Komunës.

8. Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në mënyrë të mjaftueshme dhe të hollësishme për të siguruar të dhëna të sakta të debitorëve (borxhlive) dhe janë regjistruar në mënyrë që të mundësojnë Komunën të pregadisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, të raportojë shkallën e saktë të mbledhjes, dhe të ndjekë mbledhjen e të hyrave vetanake.

6.3.3 Trajtimi i aseteve kapitale dhe jo-kapitale

Të gjeturat

Komuna ka mbajtur një regjister të plotë të pronës, impiantit dhe pajisjeve të saja. Megjithatë ne kemi identifikuar se asetet e regjistruara gabimisht dhe të asgjësuar nuk janë hequr nga regjistri i aseteve, prandaj regjistri është ekzagjeruar për vlerën 841 mijë EURO. Për më shumë vjetërsia brenda vitit është mbivlerësuar për asetet e regjistruara gabimisht. Ne nuk jemi pajisur me dëshmi të duhura të numrimit fizik të aseteve si me 31 Dhjetor 2011. Dokumentet e numërimit fizik janë përgatitur për

njësi individuale me informata të kufizuara dhe nuk ka pasur asnjë raport gjithëpërfshirës të numërimit të inventarit në nivel të Komunës siç kërkohet nga udhëzimi administrativ 21/2009.

Për më shumë, Komuna ka vlersuar pronës, impiantet dhe pajisjet në vlerën e tyre të drejt të përcaktuar në bazë të vlerësimit të kryer gjatë vitit 2011. Vlerësimi u realizua nga një komision i krijuar nga brenda. Komisioni nuk përbëhet nga vlerësues të çertifikuar dhe vlerat e raportuara në pasqyrat financiare nuk përkrahen nga asnjë raport i vlerësimit.

Konkluzion

Mosekzistimi i procedurave adekuate dhe politikës për regjistrim mund të shpie deri te trajtimi joadekuat i aseteve për shkak të kufizimeve në mjedisin kontrollues.

9. Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet që Komuna i konsideron pikat e mëposhtme në mënyrë që të përmirësojë procesin e menaxhimit të aseteve:

- Të zhvilloj dhe komunikojë një grup të politikave dhe procedurave që kanë të bëjnë me pronën, impiantet dhe pajisjet në përputhje me udhëzimin dhe termet e Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009.
- Të përditësoj (pajis me të dhëna të reja vazhdimisht) regjistrin e përgjithshëm të pronës, impiantit dhe pajiseve me hollësira të sakta.
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe çertifikuar rekomandohet si praktika më e mirë në këto raste.
- Të kryej numërime të rregullta fizike dhe raporte gjithëpërfshirëse të numërimit për të siguruar ekzistencën e aseteve dhe gjendjen e tyre dhe rezultatet e numërimit të barazohen me regjistrimet e kontabilitetit dhe regjistrin.

6.4 Trajtimi i borxheve

Detyrimet që nuk janë paguar tek furnizuesit në fund të vitit 2011 janë 111,276 EURO. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2012.

Të gjeturat

Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar disa raste kur pagesat janë bërë më shumë se 30 ditë pas datës së marrjes së faturës që nuk është në pajtim me dispozitat e Udhëzuesit të Thesarit dhe rregullës financiare 02- "Shpenzimet e parave publike".

Konkluzion

Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, pretendime të ndryshme ligjore mund të pohohen në të ardhmen dhe si pasojë ekziston rreziku i dënimeve shtesë me të cilat do të ngarkohet komuna.

10. Rekomandim

Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të ndjekë të gjitha dispozitat e Udhëzuesit të Thesarit dhe rregullës financiare 02- "Shpenzimet e parave publike" të lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të shlyej detyrimet brenda 30 ditëve.

6.5 Raportimi kohor aktual në procesin e buxhetit të përgjithshëm

Komuna ka përmbushur obligimet e jashtme të raportimit. Obligimet e përmbushura janë:

- Kërkesa buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare për nëntë muaj në kohën e duhur;
- Drafti i planit të prokurimit brenda kohës së përcaktuar
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF

Konkluzion

Komuna e Suharekës ka plotësuar në tërësi në fushën e legjislacionit në lidhje me raportimin e jashtëm.

7. Kontrolli menaxherial

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Gjatë auditimit kemi vërejtur mangësi në pasqyrat financiare vjetore, menaxhimin e të hyrave, procedurat e prokurimit dhe menaxhimin e aseteve ashtu siç është cekur në këtë raport.

Konkluzioni

Zbatimi aktual i kontroleve të brendshme është në nivel të pamjaftueshëm.

11. Rekomandim

Ne rekomandojmë Komunën e Suharekës që të :

- Forcojë kontrollet e përgjithshme financiare, administrative dhe menaxheriale; dhe
- Marrë veprimet e menjëhershme për sigurimin e një trajti më të mirë në të metat në zbatimin e kontrollit të brendshëm.

7.2. Sistemi i Auditimit të Brendshëm

Të gjeturat

Nuk ka gjetje në këtë fushë.

8. Konkluzioni i përgjithshëm mbi Komunën e Suharekës

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që Menaxhmenti i Komunës nuk ka arritur ende që të themelojë sisteme efikase të kontrollit të brendshëm. Përveç disa përmirësimeve në fushën e raportimit financiar dhe aseteve, mangësitë janë vërejtur në disa fusha të Menaxhmentit Financiar.

Menaxhmenti i Komunës duhet të ngrisë vetëdijen e menaxherëve dhe stafit për nevojën e kontrollit. Kuadri KBFP duhet të shërbej si një platform për vendosjen e kontrollit. Nevoja e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizimit është një nga kërkesat themelore për ndërtimin e një strukture të mirë të qeverisjes.

Menaxhmenti i Komunës duhet të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme raportim të besueshëm financiar dhe të vlerësojë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare. Rreziku duhet gjithashtu të vlerësohet kur është fjala për pasuritë dhe të ardhurat, kur mungojnë regjistrat dhe regjistrimet e kompletura

13.Rekomandim

Ne i rekomandojmë Komunës që të:

- Lëshoj politika të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës dhe të hartojë një plan veprimi duke specifikuar veprimet e menjëhershme
- Të zbatojë rekomandimet tona në pikat 3 deri në 7.

Shtojca I

Forma të ndryshme të Opinioneve Bazuar në ISSAI 400

(e shkëputur nga SNISA 400)

Një opinion auditimi normalisht jepet në një format standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kuadrit ligjor për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të tregojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe nëse është i kualifikuar, është i kualifikuar për disa aspekte, është një opinion kundër (paragrafi 14) ose një refuzim për të dhënë opinion (paragrafi 15).

Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare është në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

Theksim I Çështjes. Në disa rrethana auditori mund të mendojë se lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejtë pasqyrat financiare nëse nuk theksohen çështjet e rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, auditori që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keqinterpretohet si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies së kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “theksimit të çështjes” paraqiten në një paragraf të veçantë prej opinionit. Megjithatë, auditori nuk duhet të përdorë një theksim të çështjes për rregullimin e mungesës së shpalosjes së nevojshme në pasqyrat financiare, apo si një alternativë apo zëvendësues së kualifikimit të opinionit.

Një auditor mund të mos jetë në gjendje të shprehë një opinion të pakualifikuar nëse ekziston ndonjë prej rrethanave të mëposhtme dhe sipas gjykimit të auditorit efekti i tyre në pasqyra financiare është ose mund të jetë material:

- (a) Ka pasur kufizim të qëllimit të auditimit;
- (b) Auditori konsideron nëse pasqyrat janë të paplota ose keqinterpretuese, ose nëse ka një shmangje të pajustificuar nga standartet kontabël të pranuar; ose
- (c) Ka pasiguri që prekë pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar. Kur auditori nuk është dakord ose është i pasigurtë për një ose më shumë zëra të veçantë të pasqyrave financiare, të cilët janë material, por jo thelbësor për të kuptuar pasqyrat,

duhet dhënë një opinion të kualifikuar.

Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm për auditimin, subjekt ky i një deklarate të qartë dhe koncize për çështjet për të cilat auditori ka kundërshtim apo të cilat krijojnë pasiguri që sjellin kualifikimin e opinionit. Përcaktimi sasior i efektit financiar që vjen prej pasigurisë apo kundërshtimeve nga ana e auditorit, i ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse ky nuk është gjithmonë i mundur apo i rëndësishëm.

Opinion kundër. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për arsye të kundërshtimit kaq thelbësorë sa e dëmtojnë prezantimin e pozicionit në masën që një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një opinion kundër. Formulimi i një opinionit të tillë bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë të paraqitura në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe shkurtë të gjitha çështjet e kundërshtuara. Përsëri, përcaktimi sasior i efektit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave, nëse një gjë e tillë është praktike dhe e rëndësishme.

Mohim për të dhënë Opinion. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, kaq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një refuzim për të dhënë opinion. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurtë çështjet e pasigurta.

Për SAI është e zakonshme që të jepet një raport i detajuar që sqaron opinionin në rrethana kur nuk është e mundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit të paraprak

Komponentët e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të zbatuara	Pjesërisht të adresuara	Të pa adresuara
1.Përgatitja e pasqyrave financiare	Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshij procedura dhe metoda të cilat janë dizenuar për të siguruar që informacioni i kërkuar të jetë regjistruar , procesuar dhe përmbledhur dhe raportuar në menyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare	Pjesërisht	Komuna ka ndërmarrë veprime për të zbatuar rekomandimet në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare, por nuk janë zbatuar plotësisht.	
2. Menaxhimi i pronës, impianteve dhe pajisjeve	Ne rekomandojmë Komunën e Suharekës të zhvilloj dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet.në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.21/2009. Përvec kësaj dhe si minimum, regjistri i lartpermendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për cdo pasuri fikse:	Pjesërisht	Komuna ka ndërmarrë veprime për të përgatitur një regjistër të plotë të aseteve.	

	a. Datën e përvetësimit b. Vendndodhjen c. Numër i specifikuar nga komuna (numër identifikues) d. Numër serik e. Përshkrimi dhe funksioni f. Kosto g. Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qellime të taksave edhe financiare për qellime të raportimit h. Jeta e dobishme e parashikuar i. Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit j. Data e nxjerrjes jashtë përdorimit k. Burimi i Financimit l. Numri i faturës për shpenzimin e bërë			
3. Të hyrat	Ne rekomandojmë që Komuna të përmbaj regjistër të ndarë të debitorëve të saj në një sistem automatik të faturimit.. Ky informacion mund të përmirësonte dukshëm menaxhimin e të hyrave gjatë Procesit të buxhetimit dhe mbledhjes së aseteve. Menaxhmentit gjithashtu do të	Nuk është zbatuar	Pa regjistrime të mjaftueshme , të hollësishme dhe të sakta të debitorëve dhe raportimit të arkëtimeve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë buxhetin real dhe të saktë, e as të përgatisë një raport të sakt të koeficientit të arkëtimeve,	

	përfitonte duke zbatuar procesin e faturimit dhe mbledhjes së informacionit në baza të kohës reale. Lista e detajuar dhe e rifreskuar e tatimpaguesve individual,bizneseve aktive dhe debitorëve të nxjerrur nga sistemi është e rëndësishme sidomos në situatën aktuale ku komunat nuk regjistrojnë secilin transaksion individual në Free Balance.		si rrjedhojë nuk është në gjendje të përcjellë mbledhjen e të hyrave në kohë. Për më tepër, arkëtimi i ulët I të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin investues të Komunës.	
4. Shpenzimet	Ne këshillojmë komunën që në menyrë strikte të zbatojë kontrollet e krijuara p.sh. gjithë dokumentacionin burimor lidhur me faturat e mallrave do duhej autorizuar nga personi që ka pranuar	Është zbatuar		
5.Prokurimi	Ne rekomandojmë Komunën të aplikojë në mënyrë të drejtë kushtet kontraktuale dhe të aplikojë ndëshkimet (penaltitë) kur një kontraktor nuk përfundon projektin në kohë. Kjo duhet të vlejë kur kërkesa për zgjatje të afatit (para se të skadojë) sic përcaktohet në kontratë, nuk është paraqitur.	Nuk është zbatuar	Komuna nuk ka marrë asnjë veprim lidhur me zbatimin e ligjit të Prokurimit..	

Shtojca III. Komentet e Komunës së Suharekës dhe përgjigjet e Auditorit

Rekomandimet	Pajtohemi	Pajtohemi pjesërisht	Nuk pajtohemi	Komentet e Komunës së Suharekës	Komentet e Auditorit
Rekomandimi 1:			X	Ne mendojme se koficienti i realizimit të buxhetit finale në lartësi prej 94% tregon se komuna ka bërë një planifikim profesional dhe ka treguar një performancë të mirë në monitorim dhe ekzekutimit të buxhetit Bazuar në koficientin e lartë të menaxhimit të buxhetit ekipi profesional auditues do ta marr në konsiderat këtë komente.	Gjetjet e auditorit qëndrojnë
Rekomandimi 2:		X		Është e vertet se Pasqyrat financiar janë dërguar vetëm në gjuhen Shqipe bazuar në kërkesat e Thesarit ndërsa të gjeturat tjera të konstatuara shifet se nuk ka ndonjë vërejtje apo moszbatim të procedurave Ligjore	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

				-Komuna te gjitha pranimet nga palet e treat I ka te regjistruara dhe mbeshtetur ne marrveshjet per bashkfinancim me palet e treat per vitin qe perfundon me 31.12.2011 -Vlera prej 103 mije është tejkallim I te hyrave vetanake dhe eshte shpalosur ne menyre te drejte ne pasqyrat financiare. -Vlera prej 38 mije euro eshte shpalosur drejtë në pasqyrat financiare mirpo ndryshimet jane berë nga ana e thesarit pas dorzimit te pasqyrave financiare Shtojce:Vendimi mbi tejkallimin e planit buxhetor dhe raporti I analizave te SIMFK-se I dates 27.02.2012.	
Rekomandimi 3:		X		Komuna faturon per te hyrat e tatimit ne prone taksave komunale dhe qirave dhe disponon me informacion dhe kryen barazime te rregullta.	
Rekomandimi 4:			X	Fatura në shumë prej 29.814.00 blerja e karburanteve për ngrohje,fatura me vlerë prej 8.096.00 blerja e druve për ngrohje dhe fatura në vlere prej 272.00 blerja e materiait shkollor ju njoftojme se te gjitha faturat janë të kompletuara.	Gjetjet e auditorit qëndrojnë, përveq per faturen në shumë prej EUR 29,814 blerja e

				Shtojce: Informacioni I pagesave Shpresojm se ky koment do te mirret ne konsiderat.	karburanteve për ngrohje
Rekomandimi 5:		X		AK konsideron se edhe proceduren e pare epo ashtu edhe ne proceduren e dytë vleresimi ka qen i drejte dhe konform LPP-se, megjithate ne kemi zbatuar VENDIMIN E OSHP-se dhe kemi punuar konform ketyre vendimeve. Kjo ka qene edhe aresyeja qe nuk eshte marr ndonje mas ndaj menagjerit te prokurimit -menagjeri i ketij projekti ka kerkuar nje sigurim me afat shtese nga OE dhe tashme ne kemi sigurim te ezekutimit per kete project deri me date 21.08.2012. (shih kopjen e sigurimit-deshia 1). - Sa iperket fatures se rrymes, OE ka sjellur faturen e rrymes per objektin te cilin e shfrytezoon, por nuk ka sjellur kontraten me qiradhenesin. (shih kopjen e fatures-deshmia 2). - Data e dorezimit te kesaj oferte eshte 18.07.2011. OE per	

				te cilin ju keni vleresuar se ka vertetim te ATK-se jot e duhur siq eshte kerkuar. Vertetimi I ATK-se mban daten 05.05.2011 dhe I perket tremujorti te fundit siq eshte kerkuar ne dosje te tenderit. (shih kopjen e vetetimit te ATK-se- deshmia 3). - Sa i perket ndaljen e tatimit, ne ne dosjen e tenderit e specifikojme se te gjitha obligimet tatimore i kryen OE, andaj kjo ka qene arsyjeja qe kjo nuk eshte cekur ne kontrate por pjese e kontrates eshte edhe dosja e tenderit. Ndersa sa I perket pageses ne avans, ne kemi ngaterruar lenden e kontrates paraprake qe ka pasur I njejti OE, ndersa pagesa e muajit dhjetor i eshte bere me date: 13.02.2012 dhe fatura e sherbimeve per muajin dhjetor ka daten:06.01.2012. (shiko kopjen e urdherblerjes dhe fatures per muajin dhjetor se bashku me raportin per pranim te sherbimeve –deshmia 4). Shtojce :Komentet ne forme te shkruar dhe informacionet e komenteve	
--	--	--	--	--	--

Rekomandimi 6:		X			
Rekomandimi 7:	X				
Rekomandimi 8:			X	Komuna mban libra te veqanta per të gjitha të hyrat vetanake te cilet ngarkohen me detyrime si taksa komunale tatimi ne prone dhe qirat ndersa te hyrat tjera si qertifikatat e lindjes dhe te ndryeshme dhe lejet ndertimore te hyrat realizohen menjeher pasi te kryhet sherbimi dhe per te hyrat e realizuar ne baza ditore ne forme te shkruar harmonizohen informacionet me ZHK Shtojce :Faturat te faturuar në mënyrë automatike të taksave komunale të qirave dhe tatimit në pronë	Gjetjet e auditorit qëndrojnë
Rekomandimi 9:		X		Pasurit kapitale në vlerë mbi 1000.00€ identifikohen dhe evidentohen në regjistrin kontabel te menaxhuara nga ana e Thesarit.Asetet gabim te regjistruar janë të evidentuar ne regjistrin kontabel dhe thesari nuk ka berë modifikime ne regjistrin e tyre per deri sa në regjistrin e pasurise menaxhuar nga komuna per asetet gabim të regjitruar vlera neto në libra	

				është procesuar me xero vlere .Ne kemi kerkuar edhe gojarisht dhe ne formë të shkruar nga ana e thesarit qe te behen korigjime per asetet gabim te regjistruar por nuk na eshte lejuar qasje ne program per korigjimin e asetëve gabim te regjistruar. Ne menojme se kjo e gjetur duhet t iu adresohet thesarit.	
Rekomandimi 10:	X				
Rekomandimi 11:		X		Te sistemi I menaxhimt të te hyrave dhe menaxhimi i asetëve kontrolli menaxheriale ka shënuar nje progress te shtuar.	
Rekomandimi 12:			X		Gjetjet e auditorit qëndrojnë
Rekomandimi 13:	X				



Grant Thornton

An instinct for growth™

www.grant-thornton.com.mk